



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike

Nr. _____ /2021

Dt. 06 / 12 /2021

RAPORT VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2021

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN

Nr. i kësaj qelie: D.M.S.H.Publike 41108

Nr. i kësaj qelie: 09 Nr. i kësaj qelie: 06.12.21

DEÇAN DEÇANE

E përgatiti :
Shefe e Sektorit për Siguri dhe Emergjencë


Gentiana Mazrekaj



Miratoj :
Drejtori për D.M.SH.S.H.P.


Azet Zenuni

HYRJE

Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, konkretisht Sektori për Mbrojtje, Shpëtim duke u bazuar në misionin dhe qëllimet e tij gjatë vitit 2021 ka arritur që ti kryej punët dhe detyrat e planifikuara një vit më parë rreth parandalimit, evitimit, rekomandimeve të rreziqeve të mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Gjatë vitit 2021 territorin e Komunës së Deçanit e kanë përcjell situata emergjente të natyrave të ndryshme si: zjarre, fatkeqësi në komunikacion etj, konkretisht me theks të veçantë në Janar të vitit 2021 vërshimet që kanë shkaktuar dëme materiale si në shtëpi banimi, në infrastrukturë rrugore etj. Rasti tjetër që ka ngritur gjendjen emergjente në nivel lokal dhe me koordinim me nivelin qendror është rasti i helmimit me ujë të pijshëm në muajin Korrik.

Gjithashtu gjatë gjithë vitin ka vazhduar ballafaqimi me pandeminë Covid-19 ku ne si sektor kemi pas detyrat dhe angazhimet kryesore rreth menaxhimit, kujdesin e familjeve me nevojë etj.

Sektori për Mbrojtje Shpëtim është mar edhe me punë e detyra tjera që dalin nga objektivat dhe planifikimet e drejtorisë në mënyrë periodike ashtu siç janë të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2021.

Raporti vjetor do të përmbaj planifikimet e parapara, situatat emergjente, planet të reja të punuara, dokumentet e nevojshme ku të gjitha këto do të jenë të përpiluara në formë tabelare në baza mujore dhe vjetore:

<u>Nr.</u>	<u>Aktivitetet</u>	<u>Periudha</u>
1.	Përgatitja e planeve të punës, raportin vjetor dhe dokumente tjera bazike për vitin 2021	Dhjetor 2020
2.	Përgatitja e Dokumentacionit (lëndëve të miratuara) për Arkivim	Janar
3.	Ballafaqimi me situatën emergjente të vërshimeve të cilat shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale në tërë territorin e Komunës së Deçanit. Krijimi i komisionit për vlerësimin e dëmeve, dalja në teren dhe vlerësimi i dëmeve materiale në ekonomi familjare dhe infrastrukturë rrugore. Përpilimi i raportit i detajuar mbi situatën e krijuar.	Janar
4.	Hartimi dhe përfundimi i planit “ Pikat më vërshuese nga të reshurat atmosferike në tere territorin e Komunës së Deçanit si dhe gjendja e urave në tërësi” Shih linkun: https://kk.rks-gov.net/decan/ep-content/uploads/sites/9/2021/01/Plani-Pikat-me-Vershuese-nga-te-Reshurat-Atmosferike-dhe-Gjendja-e-Urave-ne-Teresi.pdf	Janar
5.	Hartimi dhe përfundimi i planit “ Objektet e vjetra që paraqesin rrezik për qytetarët nga shembja në territorin e Komunës së Deçanit” Shih linkun: https://kk.rks-gov.net/decan/ep-content/uploads/sites/9/2021/01/Plani-Objektet-e-Vjetra-qe-Paraqesin-Rrezik-per-Qytetaret-nga-Shembja.pdf	Janar
6.	Pas formimit të komisionit për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet janë bërë sanimet në infrastrukture rrugore, kanalizim, ura të dëmtuara nga vërshimet. Gjithashtu është përfunduar raporti për vlerësimin e dëmeve dhe i njëjti u është dërguar institucioneve përgjegjëse.	Shkurt
7.	Përcjellja dhe monitorimi i pastrimit të rrugëve dhe trotuareve nga bora	Shkurt
8.	Gjatë vitit 2021 Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Sh. Publike ka pranuar 250 kërkesa në Intranet ku 242 janë miratuar, 2 refuzuar, 2 anuluar dhe 4 janë në proces.	Gjatë vitit
9.	Takime të rregullta me Policinë, Kfor-in dhe organizata tjera	Gjatë vitit

10.	Pjesëmarrje në takime të rregullta të KKSB-së	Gjatë vitit
11.	Trajnim “Sistemi i të hyrave në pagesa elektronike(epëlqimet) - Inspektori kundër zjarrit	Maj
12.	Edhe gjatë vitit 2021 ka vazhduar përballja me Covid-19, është bere monitorimi, evidentimi, shpërndarja e ndihmave familjeve me nevojë, lejeqarkullimet jashtë orarit të kufizuar, dezinfektimet e shkollave dhe objekteve publike dhe asistime tjera sipas nevojave dhe kërkesave si nga qytetaret ashtu edhe nga institucionet lokale etj.	Gjatë vitit
13.	Bashkëpunim dhe kontakt të vazhdueshme me NJ. P. Z. Sh. – Deçan	Gjatë vitit
14.	Komunikim i vazhdueshme dhe bashkëpunim më QRAKE-Pejë	Gjatë vitit
15.	Njoftim/ apel qytetareve për vetëdijesim dhe kujdes nga zjarret. Njoftimi është bërë në forme te video mesazhit si dhe në forme të shkruar ku është shpërndarë në tërë territorin e Komunës së Deçanit. Shih linkun: https://www.facebook.com/1436712959903376/videos/1127220677787611/	Qershor
16.	Azhurnimi në INTRANET i kërkesave të qytetarëve dhe organizatave të ndryshme të cilat adresohen në Drejtorinë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.	Gjatë vitit
17.	Në fillim të muajin Korrik ka ndodhur një helmim masiv nga uji i pijshëm. Krijimi i Qendrës Operative Emergjente Lokale, funksionalizimi i Shtabit Emergjent. Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike konkretisht Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim ka udhëhequr Qendrën Operative, ka mbajt komunikim të vazhdueshëm me institucionet lokale dhe qendrore, ka bërë koordinimin e aktiviteteve etj. Pas ndërprerjes së ujit të pijes është bërë shpërndarja e ujit nga donatoret për ato zona ku ka ndodhur helmimi. Për të gjitha aktivitetet gjatë asaj kohe të helmimit është edhe raporti i detajuar i dt.28.07.2021	Korrik
18.	Pritja dhe efikasiteti në punë rreth nevojave dhe kërkesave të bashkatdhetarëve.	Korrik-Gusht
19.	Monitorimi, koordinimi dhe mbikëqyrja së bashku me NJPZSH-në rreth zjarreve fushore dhe malore	Gusht

20.	Azhurnimi i Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera të shkollave dhe Institucioneve Publike në komunën e Deçanit.	Shtator
21.	Planifikimi i projekteve dhe i buxhetit për vitin 2022 për sektorin Mbrojtje Shpëtim	Tetor
22.	Pjesëmarrje e zyrtarëve të drejtorisë në trajnimin dy ditor “ Menaxhimi i fatkeqësive natyrore”.	Tetor
23.	Përmbyllja e kontratës për mirëmbajtjen e kamerave.	Tetor
24.	Analiza e punëve dhe detyrave të planifikuara dhe të realizuara për vitin- 2020	Nëntor
25.	Përgatitja e planit vjetor të punës për vitin 2021	Dhjetor
	Shënim: Radiolidhjet e dorës janë jashtë funksionit për shkak të baterive të shpenzuara si dhe Radiolidhjet bazë nëpër BL janë të demoluara pjesërisht. Të njëjtat kanë nevojë për servisim komplet si dhe i tërë rrjeti i komunikimit.	

Plani Vjetor nga Inspektori i parandalimit nga zjarri

- Në librin e protokollit të shkurtër janë evidentuar 33 shkresa si: Akte përcjellëse, Autorizime, Ftesa për palët, njoftime për përfundimin e procedurës ligjore, konkluzionet kërkesa për plotësim lënde e tjera të cilat punë kanë qenë të pa planifikuara mirëpo janë të domosdoshme gjatë zhvillimit të procedurës ligjore.
- Takime pune dhe konsultime e Drejtorisë për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime KK- Deçan dhe takime tjera me A.M.E-në – Departamenti i parandalimit ndaj zjarrit në Prishtinë.
- Takime punë me zyrat e parandalimit ndaj zjarrit me Komunitet fqinjë. Takime zyrtare me përfaqësuesin juridik të objekteve me rëndësi të veçantë nga mbrojtja e zjarrit.
- Trajnim në lokalet e AME-së 26.05.2021 tema: Sistemi i ri i pagesave online (epelqimet).
- Trajnim me dt.21.10.2021 në IPAK, tema” Menaxhimi i fatkeqësive natyrore”
- Kryerja e disa punëve të përditshme administrative: si përgatitja e fletë dorëzimeve, dërgimi i shkresave palëve në procedurë nëpërmjet shërbimit të postës dhe direkt në dorë, përgatitja e thirrjeve për palët në procedurë, konsultime me palët , evidentimi në regjistrat e inspektimeve e tjera.

Më poshtë gjeni të bashkangjitur tabela që paraqesin punët dhe aktivitetet vjetore si dhe foto nga ngjarjet e ndryshme 2021:

	Nr. I përgjithshëm I daljeve në teren të inspektorit për parandalim ndaj zjarrit	Konstatime dhe verifikime të zjarreve	Nr. I përgjithshëm I I intervenimeve teknike dhe shërbime të zjarrfikësve	Hartimi i raporteve të zjarreve dhe vërtetimeve të dërguara Policisë së Kosovës dhe palëve.		Dhënie e pëlqimeve në dokumentacion in investivo-teknik për objekte të ndryshme	Aksidente në Komunikacion			
				Raportet e zjarrit	Vërtetime nga zjarri		Dëme materiale	Të lënduar	Të vdekur	Interv. i NJPZSH-së në aksidente
Janar	4	3	4	3		1				
Shkurt		4	3							1
Mars		9	2							
Prill	13	12	0	2						
Maj	5	17	3	3		1				1
Qershor	4	10	2	5						
Korrik	3	12	2	3	1					1
Gusht	5	44	3	4		1				3
Shtator	4	29	0	4	1					
Tetor	1	3	0	2						
Nëntor		3	2							
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	39	146	21	26	2	3				6

Numri i përgjithshëm i zjarreve dhe llojet e intervenimeve gjatë vitit 2021													
	Lloji i intervenimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1.	Zjarre malore	0	1	2	4	6	2	3	9	8	0	1	-
2.	Zjarre fushore	0	1	6	1	2	3	6	26	15	0	0	-
3.	Zjarre në objekte banimi dhe objekte përcjellëse	1	0	0	2	6	1	0	4	5	0	0	-
4.	Zjarre në objekte afariste banesore	0	0	0	1	0	0	0	0	0	1	0	-
5.	Zjarre në automjete	0	0	0	1	1	1	0	1	0	1	0	-
6.	Të ndryshme	2	2	0	5	2	2	3	4	1	1	2	-
	Gjithsej:	3	4	8	14	17	9	12	44	29	3	3	-

Foto nga aktivitetet e ndryshme gjatë vitit 2021- Sektori Mbrojtje dhe Shpëtim

Foto 1. - Foto nga tereni dhe raporti mbi vlerësimin e dëmeve nga vërshimet



Foto 2 “Dorëzimi i planit “Pikat më vërshuese nga të reshurat atmosferike në territorin e K.Deçanit si dhe gjendja e urave në tërësi”



Foto 3 - Dorëzimi i Planit “ Objektet e vjetra që paraqesin rrezik për qytetaret nga shembja në territorin e Komunes së Deçanit”



Foto 4 – Takime të rregullta me Policinë, Fsk-në, Kfor-in si dhe KKSBB-në



Foto 5 – Helmimi i qytetarëve nga uji i pijshem (Korrik)




Foto 6 – Foto të zjarreve dhe intervenimet nga Njësia e Zjarrfikësve Deçan



Foto 7 – Ballafaqimi me Covid-19



Përfundim

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë vitit 2021 ka kryer punët dhe aktivitetet e parapara në shumicën e planifikimit duke marr parasysh edhe situatat e pa planifikuara siç është pandemia Covid 19 dhe helmimet qe kanë ndodhur në muajin Korrik.

Raporti I punës përshkruan aktivitet e vitit 2021 nga Sektori për Mbrojtje e Shpëtim në bashkëpunim edhe me sektorët tjerë komunal po ashtu edhe me institucionet lokale që kanë të bëjnë në fushën e menaxhimit të emergjencave si në parandalim ,rekomandime ,ndërhyrje në eliminimin e pikave të rrezikut dhe detyrave tjera ashtu siç është e paraparë sipas organo-gramit dhe përshkrimit të detyrave .